

Hap thirrjen për aplikim për mobilitete, në "Savonia University of Applied Sciences", Finlandë, në kuadër të programit Erasmus+ DualAFS, për semestrin veror 2022/2023 (prej 9 Janar – 7 Prill, 2023)



Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë hap thirrjen për aplikim për mobilitete, në "Savonia University of Applied Sciences", Finlandë, në kuadër të programit Erasmus+ DualAFS, për semestrin veror 2022/2023 (prej 9 Janar – 7 Prill, 2023).

#### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

Shkëmbimin e studentëve për studime Bachelor (7 bursa 3 mujore) për semestrin veror 2022/2023.

Kandidatëve të përzgjedhur për këtë mobilitet, do të iu mbulojnë shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit dhe pagesa e semestrit në Universitetin pritës, sipas udhëzimit të programit Erasmus+ DualAFS.

Të drejtë aplikimi kanë studentët e programit: BSc.Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore (Viti II dhe III)

#### **Kurset që ofrohen:**

<b>Nr.</b>	<b>Të obligueshme</b>	<b>Nr.</b>	<b>Zgjedhore</b>
1	Orientation (1 ECTS)	1	Circular Economy in Agriculture (5 ECTS)
2	Communication skills (5 ECTS)	2	Animal Production and Environment (3 ECTS)
3	Survival Finish (3 ECTS)	3	Agriculture in Global Context (5 ECTS)
		4	Animal Welfare (5 ECTS)
		5	Animal Breeding Practices (3 ECTS)
		6	English for Working Life (5 ECTS)

		<b>7</b>	Research Methodology (3 ECTS)
		<b>8</b>	Food Chain Challenges (5 ECTS)
		<b>9</b>	Green Care (5 ECTS)

**Studentët duhet të akumulojnë së paku 15 ECTS.**

**Vërejtje:** Studentët janë obliguar të përmbushin kërkesat rreth regjistrimit të semestrave në Universitetin "Isa Boletini" Mitrovicë.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- CV (në gjuhën angleze).
- Kopja e pasaportës (faqja që përmban emrin, foton dhe të dhënat personale)
- Kërkohen njohuri të mjaftueshme komunikimi në gjuhën angleze (e barasvlershme me nivelin B1).
- Letër motivuese në gjuhën angleze.

**Afati për aplikim është deri më 09 Tetor 2022 deri në ora 16:00.** Intervistimi i aplikantëve do të bëhet me datë 10 tetor 2022, prej orës 10:00, në sallën e mbledhjeve të FTU-së.

Dokumentet me titull "Savonia University" duhet të dërgohen të skanuara në pdf file, tek: [mehush.aliu@umib.net](mailto:mehush.aliu@umib.net).

Vetëm dokumentet e kompletuara do të merren në konsideratë.

Për më shumë informata rreth mobiliteteve dhe dërgimit të dokumenteve mund të adresoheni në e-mailin [arber.hyseni@umib.net](mailto:arber.hyseni@umib.net).